



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT TË
NDIHMËS SË HUAJ

**ANALIZA
E
BORXHIT PUBLIK**

(Viti 2020)

PËRMBAJTJE

PËRMBLEDHJE	2
1. Ecuria e Borxhit Publik	4
2. Borxhi Shtetëror	5
3. Borxhi Shtetëror i Garantuar	7
4. Huamarrja	8
4.1. Huamarrja e Brendshme	9
4.2. Huamarrja e Huaj	10
5. Kosto dhe Risqet	11
5.1. Kosto	11
5.2. Risqet.....	12
6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë	14
6.1. Ecuria e ankandëve dhe kërkesa për titujt shtetërorë	14
6.2. Ecuria e normave të interesit	15
ANEKSI I (Akronime dhe Fjalor Shpjegues)	16
ANEKSI II (Të Dhëna Shtesë)	20

PËRMBLEDHJE

Borxhi publik gjatë vitit 2020 përgjithësisht është menaxhuar në përputhje me objektivat strategjikë afatmesëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Pavarësisht nevojave për hua në rritje të krijuara nga pandemia COVID-19 si dhe nga tërmeti i fundit të vitit 2019, huamarrja gjatë vitit 2020 ka arritur të përmbushë plotësisht nevojat buxhetore, si edhe të gjitha nevojat që burojnë nga detyrimet e borxhit ekzistues. Në këtë drejtim vlen për t'u përmendur emetimi me sukses i Eurobond-it me vlerë 650 milion Euro në tregjet ndërkombëtare, i cili përveçse plotësoi nevojat për likuiditet, përçoi një sinjal pozitiv përse i përket aftësisë për të siguruar fonde dhe qëndrueshmërisë së financave publike në Republikën e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2020, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,224.47 miliard Lekë ose 77.9% e PBB, duke shënuar një rritje në nivelin e borxhit publik në raport me PBB me 11.6 pikë përqindje, krahasuar me nivelin e vitit të mëparshëm.

Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 471 miliard Lekë, nga të cilat 74.2% (ose 349.7 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 25.8% (ose 121.3 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Gjatë vitit 2020 nevoja për huamarrje ka shënuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, duke reflektuar kërkesën e shtuar të qeverisë për financim, si pasojë e një sërë faktorësh si, thellimi i defiçitit për shkak të të ardhurave më të ulëta të realizuara gjatë vitit 2020, masave fiskale të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19, nevojave të rindërtimit nga tërmeti. Huamarrja u realizua nëpërmjet burimeve të brendshme dhe burimeve të huaja, përkatësisht në nivelin 97.3% dhe 83.6% të planit vjetor¹.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2020 u menaxhua reduktimi i mëtejshëm i ekspozimit ndaj risqeve të borxhit të brendshëm, si edhe u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë kësaj periudhe është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së *yield-it* në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë.

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë vitit 2020 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive. Kërkesa për tituj shtetërorë, megjithëse mbetet ende jo shumë e diversifikuar dhe e bazuar kryesisht tek sektori bankar, pothuaj gjatë gjithë vitit 2020 ka qenë e kënaqshme dhe ka mbuluar plotësisht nevojat e qeverisë për huamarrje të brendshme.

¹ Referuar planit vjetor në Aktin Normativ Nr. 34, datë 16.12.2020, "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 88/2019 "Për Buxhetin e Vitit 2020"", i ndryshuar.

Pavarësisht huamarrjes a-tipike të lartë dhe intensive gjatë vitit 2020, pothuajse të gjitha ankandet e titujve qeveritare kanë qenë relativisht të suksesshme, me nivele mbulimi mbi 1, duke mos reflektuar rritje substanciale të normave të interesit.

Gjatë vitit 2021 dhe në vijim, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si edhe mbajtjes nën kontroll të kostove.

Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të realizohet huamarrja e re e planifikuar.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja do të plotësojë financimin e nevojshëm, duke kontribuar në uljen e presionit për hua në tregun e brendshëm, optimizimin e kostos së borxhit, si edhe sigurimin e pjesshëm të flukseve valutore të nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë.


Burimet kryesore të huamarrjes së huaj do të jenë huatë me terma të buta ose pjesërisht të buta, cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për të mbështetur reformat dhe politikat zhvillimore të vendit.

Pjesa e mbetur e financimit të huaj planifikohet të realizohet nëpërmjet burimeve private, ku si instrument huaje planifikohet të përdoret Eurobond-i, duke mos përjashtuar instrumentet e tjera financiare të tregjeve të kapitalit mbi baza oportuniste. Huamarrja nëpërmjet këtyre burimeve do të përdoret kryesisht për të menaxhuar detyrimet e borxhit në valutë duke përfshirë këtu rifinancimin e Eurobondit që maturohet në vitin 2025.

1. Ecuria e Borxhit Publik

Në fund të vitit 2020, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,224.2 miliard Lekë ose 77.9% e PBB². Në terma nominal, stoku i borxhit publik është rritur më rreth 111.6 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2019, nga të cilat 46.6 miliard Lekë i përkasin borxhit të brendshëm dhe 65 miliard Lekë borxhit të jashtëm. Rritja e stokut të borxhit ka ardhur kryesisht nga masat e mara në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë Covid 19, si dhe nga emetimi i Eurobondit në muajin qershor 2020 (*fond nga i cili 250 milion Euro u përdoren për ripagimin e Eurobondit të vitit 2015 i cili u maturua në muajin nëntor 2020*).

Paraqitje Grafike 1 (a): Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2016–Shtator 2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit publik janë përkatësisht rreth 52.6% dhe 47.4%, duke shënuar një rritje në drejtim të borxhit të jashtëm me 1.1 pp.

Për sa i përket kompozimit të portofolit të borxhit publik sipas instrumenteve, më shumë se gjysmën e peshës vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (*bono thesari, obligacione, Eurobond*). Konkretisht pesha e instrumenteve të tregtueshme është 63.1%, peshë e cila ka shënuar një rritje me 2.6 pp krahasuar me fundin e vitit 2019, si rezultat i emetimit të Eurobondit si edhe rritjes së emetimeve të titujve shtetërorë në tregun e brendshëm për të mbuluar nevojat për hua në rritje.

Paraqitje Grafike 1 (b): Përbërja e borxhit publik sipas instrumenteve (2016–Shtator 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


² PBB mbi bazë vjetore, referuar të dhënave në “Kudrin Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2022-2024”, miratuar me VKM Nr. 7, datë 13.01.2021.

Borxhi i pushtetit lokal vazhdon të qëndrojë në nivele të ulëta (rreth 432 milion Lekë/apo 0.03% e PBB), kryesisht për shkak të kapaciteteve të ulëta që kanë njësitë e qeverisjes vendore për të akumuluar borxh të ri. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur asnjë kërkesë nga njësitë e qeverisjes vendore për huamarrje të re, ndaj niveli i borxhit të pushtetit lokal ka pësuar rënie prej 149.6 milionë lekë në krahasim me fundin e vitit 2019.

2. Borxhi Shtetëror

Gjatë vitit 2020 portofoli i borxhit shtetëror vazhdon të dominohet mbi 50% nga titujt shtetërorë të tregtuar në tregun vendas, në përputhje me objektivat strategjike, ndërkohë që është rritur me 3.6 pp pesha e titujve ndërkombëtarë si rezultat i emetimit të Eurobond-it në muajin qershor 2020.


Paraqitje Grafike 2 (a): Kompozimi i portofolit të borxhit shtetëror sipas instrumenteve (2016–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, gjatë vitit 2020, është mundur mbajtja e një peshe pothuajse të njëjtë me vitin e mëparshëm të titujve afatgjatë (titujt me afat maturimi mbi 5 vite) ndërkohë është ulur ndjeshëm pesha e titujve afatshkurtër (deri në një vit) e kompesuar kjo me një rritje të peshës së titujve me afat 1-3 vite. Gjithashtu, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës.


Paraqitje Grafike 2 (b): Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2016–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 50% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse e cila është rritur më tej gjatë vitit të fundit me 3.1 pikë përqindje. Ndërkohë, për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme (*Eurobond-i*), peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë kreditë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore. Megjithatë kjo pjesë e portofolit ka pësuar rënie gjatë viteve të fundit, ku në 2020 pësha e stokut të borxhit referuar këtyre kredive është ulur me 7.3 pikë përqindje.


Paraqitje Grafike 2 (c): Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve dhe tipit të interesit (2016–2020)



Në fund të vitit 2020, pjesën më të madhe të portofolit të borxhit shtetëror e zë valuta vendase me 52.6% të totalit, ndjekur nga valuta EUR me 33.5% dhe USD me 9.1%. Krahasuar me fundin e vitit 2019, vihet re një rritje e peshës së borxhit të denominuar në monedhën Euro me 3.9 pikë përqindje, si rezultat i emetimit të Eurobond-it në muajin qershor 2020, si dhe emetimit të obligacionit dy vjeçar në Euro në muajin prill 2020.

Në portofolin e borxhit të brendshëm, pjesa më e madhe përbëhet nga monedha vendase dhe vetëm 2.0% përbëhet nga monedha Euro, në përputhje me politikat menaxhuese për të kufizuar ekspozimin e portofolit të borxhit ndaj riskut të kursit të këmbimit. Ndërkohë, portofoli i borxhit të jashtëm kompozohet tërësisht nga valuta të huaja, ku mbizotëron me 70.1% valuta EUR, e ndjekur nga USD me 19.7%.

Paraqitje Grafike 2 (d): Kompozimi i borxhit shtetëror sipas valutës (2020)




3. Borxhi Shtetëror i Garantuar

Në fund të vitit 2020, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 49.8 miliard Lekë (3.1% e PBB) ose 4% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore. Në stokun e garancive përfshihen dhe dy garancitë që emtoi qeveria e Republikës së Shqipërisë gjatë muajve prill – maj 2020, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Për të mbështetur tregtarët dhe shoqëritë tregtare me likuiditet, Qeveria e Republikës së Shqipërisë emtoi Garancinë Shtetërore në shumën prej 11.0 miliard Lekë për kompanitë që kishin vështirësi në pagimin e pagave të punonjësve. Sipas kësaj skeme, shpenzimet e interesit mbulohen plotësisht nga qeveria dhe nuk kërkohet asnjë kolateral nga kompanitë. Përveç Garancisë së parë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë emtoi një Garanci Shtetërore të dytë, në shumën prej 15.0 miliard Lekë, duke siguruar hua për kapital qarkullues dhe investime për të gjithë sektorët e ekonomisë. Në këtë skemë garancie, Qeveria garantoi 60% të principalit. Gjithsej nga qeveria u akorduan 26 miliard Lekë në formën e garancive, të cilat deri në fund të vitit 2020 mundësuan kreditimin e shoqërive tregtare me 14.9 miliard Lekë. Deri në fund të vitit, Garancia Sovrane 1 është përdorur në masën prej rreth 54% (vlera e miratimeve kundrejt totalit) ndërsa Garancia Sovrane 2 është përdorur në masën prej 36%, ku kjo e fundit do vazhdojë të përdoret deri në afatin e shtyrë për aplikime (30.06.2021).

Paraqitje Grafike 3 (a): Portofoli i borxhit të garantuar sipas rezidencës së kreditorit (2016–2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Rikompozimi i pjesës më të madhe të portofolit të garancive të emtuara në favor të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (*KESH sh.a.*) nga linja huaje afatshkurtra në hua afatgjatë, ka zbutur ndjeshëm riskun e rifinancimit të detyrimeve të kësaj kompanie, i cili mund të buronte nga risku sistematik i sektorit bankar ose ndryshimi i politikave investuese të bankave që kishin financuar linjat e huave. Rrjedhimisht, edhe risku në buxhetin e qeverisë qendrore për materializimin e këtyre detyrimeve nga detyrime indirekte në detyrime të drejtpërdrejta është reduktuar. Disbursimi i kredisë së BERZH, kjo e garantuar nga Qeveria, me qëllim ristrukturimin e kredive afatshkurtra të KESH sh.a, ka sjellë dhe rritje të peshës së garancive të huaja në portofolin e garancive.

Megjithatë, risku nga detyrimet kontigjente në buxhetin e shtetit vijon të jetë i konsiderueshëm, pasi më shumë se 65% e garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke e bërë buxhetin të ndjeshëm ndaj çdo risku që mund të paraqesë ky sektor

Paraqitje Grafike 3 (b): Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2016–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


4. Huamarrja

Huamarrja gjatë vitit 2020 u realizua në linjë me nevojat buxhetore të rritura në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga përhapja e pandemisë COVID-19 si dhe për shkak të nevojave për rindërtim. Nëpërmjet huamarrjes u mundësua refinancimi i borxhit ekzistues, menaxhimi i nevojave për likuiditet, si edhe financimi i deficitit të planifikuar për vitin 2020.

Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 471 miliard Lekë, nga të cilat 74.2% (ose 349.7 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 25.8% (ose 121.3 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Rreth 362.8 miliard Lekë shërbyen për refinancimin e borxhit ekzistues, ndërsa pjesa tjetër për mbulimin e nevojave të qeverisë për likuiditet dhe mbulimin e deficitit buxhetor të planifikuar.

Huamarrja në raport me PBB, si edhe në raport me të ardhurat tatimore gjatë vitit 2020 kanë shënuar një rritje përkatësisht me 10.7 pp dhe 42.5 pp, kjo si nga efekti i nevojave të shtuara për financim në vitin e fundit, por edhe si efekt i tkurrjes së PBB dhe uljes domethënëse të të ardhurave të shënuar për shkak të situatës së pandemisë.

Viti 2020 shënon një vit të pazakontë sa i takon këtyre treguesve të nivelit vjetor të huamarrjes, tregues që priten të shkojnë drejt normalizimit nisur nga viti 2021 që konsiderohet një vit i kthimit drejt normalitetit.

Paraqitje Grafike 4 (a): Huamarrja bruto në vlerë absolute dhe në raport me të ardhurat tatimore dhe PBB (2016–2020)

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

4.1. Huamarrja e Brendshme

Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 349.7 miliard Lekë, nga të cilat 223.9 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatshkurtër dhe 125.8 miliard Lekë nëpërmjet titujve afatgjatë. Rreth 86.1% e huamarrjes së brendshme ka shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër për të shërbyer nevojat buxhetore të planifikuara në rritje kryesisht për shkak të pandemisë COVID-19.


Tabela 4.1(a): Huamarrja e brendshme (Viti 2020)

Lloji i Titullit	Viti 2020			
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në %)
Tituj Afatshkurtër	223,9	217,2	6,7	13,8%
Bono Thesari në Lekë	223,9	217,2	6,7	13,8%
Tituj Afatgjatë	125,8	84,0	41,9	86,2%
Obligacione 2 vjeçare	44,2	45,9	-1,8	-3,6%
Obligacione 2 vjeçare në Euro	12,6	0,0	12,6	26,0%
Obligacione 3 vjeçare	20,2	3,0	17,2	35,3%
Obligacione 5 vjeçare	18,5	13,5	5,0	10,4%
Obligacione 7 vjeçare	16,9	21,5	-4,7	-9,6%
Obligacione 10 vjeçare	13,5	0,0	13,5	27,7%
Gjithsej Tituj Shtetërorë	349,7	301,1	48,6	100,0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Pavarësisht nevojave për hua në rritje dhe pasigurisë së krijuar në tregun e titujve shtetërorë, pjesa më e madhe e borxhit të ri është huazuar nëpërmjet titujve afatgjatë (rreth 86.2% e totalit), duke qenë në linjë me objektivat strategjike afatmesëm për reduktimin e riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit.

Paraqitje Grafike 4.1: Huamarrja e brendshme në terma neto sipas titujve shtetërorë (2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

4.2. Huamarrja e Huaj

Gjatë vitit 2020, huamarrja e huaj u realizua në nivelin 121.3 miliard Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, huamarrja e huaj është rritur me rreth 99.9 miliard Lekë, si rezultat i emetimit të Eurobondit dhe disbursimeve në fomën e mbështetjes buxhetore, si suport për qeverinë në kushtet e pandemisë. Në këtë drejtim vlen për t'u përmendur:

- Eurobondi i emetuar në muajin qershor 2020, në vlerën 650 milion Euro, një pjesë e të cilit cili shërbeu për refinancimin e 250 milion Euro të Eurobondit ekzistues të emetuar në vitin 2015 dhe detyrimeve të tjera në valutë, si edhe për të përmbushur nevojat buxhetore të planifikuara për vitin 2020.
- Mbështetja buxhetore e akorduar nga FMN në vlerën 174 milion Euro nëpërmjet Instrumentit të Shpejtë të Financimit (RFI), e cila do të shërbejë për të përballuar nevojat urgjente të bilancit të pagesave nga përhapja e pandemisë së COVID-19 dhe tërmeti në nëntor 2019.

Për sa i përket huamarrjes së huaj për financimin e projekteve, pothuajse gjysma e huamarrjes së huaj bruto është realizuar në drejtim të sektorit të transportit, ndjekur nga sektori i ujësjellës kanalizime dhe ai i energjisë.

Tabela 4.2 (a): Huamarrja e huaj në terma bruto (2020)

Huajamarrja e Huaj Bruto	2019		2020	
	Vlera (në mld Lek)	%/Total	Vlera (në mld Lek)	%/Total
Kredi për financim projektsh	19,6	91,9%	17,4	14,3%
Energjia	1,2	5,6%	1,8	1,4%
Transporti	9,5	44,4%	9,0	7,4%
Ujësjellës Kanalizime	4,7	21,9%	4,3	3,6%
Infrastruktura Urbane	3,1	14,6%	0,7	0,6%
Të Tjera	1,1	5,3%	1,6	1,3%
Mbështetje Buxhetore	1,7	8,1%	23,8	19,6%
Eurobond	0,0	0,0%	80,1	66,1%
Total Huamarrja e Huaj	21,4	100,0%	121,1	100,0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

5. Kosto dhe Risqet


Gjatë vitit 2020, menaxhimi i borxhit ka mundësuar reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj pjesës më të madhe të risqeve duke mbajtur koston nën kontroll. Struktura e borxhit është përmirësuar, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Përmirësimi i raportit ndërmjet koston dhe risqeve të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit është mundësuar edhe pse të ndodhur në kushtet e nevojave të rritura së tepërmi për financim. Kjo ka ardhur jo vetëm si rezultat i mirëmenaxhimit në përputhje me objektivat strategjike, por edhe si rezultat i kushteve të favorshme të tregjeve si:

- Normat e ulta të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj, si rezultat i politikave monetare lehtësuese të bankave qendrore;
- Disponueshmëria në nivele të konsiderueshme e burimeve të huaja të financimit me terma koncesionale;
- Kërkesa e kënaqshme për titujt shtetërorë afatgjatë me norma interesi fikse;

5.1. Kosto

Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet për interesa në vitin 2020 vlerësohen rreth 0.75 miliard Lekë më të ulëta, kryesisht si rezultat i uljes së shpenzimeve për interesa në portofolin e borxhit të brendshëm. Shpenzimet për interesa në portofolin e borxhit të huaj kanë pësuar gjithashtu një ulje në krahasim me ato të vitit 2019.

Paraqitje Grafike 5.1 (a): Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (2016-2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Reduktimi i shpenzimeve për interesa të borxhit në tërësi ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së normave të interesit gjatë viteve më të fundit, gjë e cila ka mundësuar rikompozimin e portofolit me tituj dhe kredi më pak të kushtueshme.

Kosto për njësi e portofolit të borxhit shtetëror ka vazhduar të ulet edhe përgjatë vitit 2020, kryesisht si rezultat i normave të interesit në nivele ende të ulëta, shoqëruar me rifinancimin e borxhit që maturohet (kryesisht atij afatgjatë) me borxh më pak të kushtueshëm.

Reduktim i kostos për njësi është shënuar si në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, ashtu edhe në borxhin e jashtëm shtetëror.

Portofoli i borxhit të jashtëm vijon të ketë kosto ndjeshëm më të ulët se portofoli i borxhit të brendshëm, kryesisht për shkak të stokut me terma koncesionale, dhe emetimit të instrumenteve të tregtueshme si Eurobond-i në tregje më konkurruese dhe më likuide se tregu vendas.

Paraqitje Grafike 5.1 (b): Kosto mesatare e borxhit shtetëror (2015-2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

5.2. Risqet

Gjatë vitit 2020 ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është menaxhuar përgjithësisht në linjë me objektivat strategjikë afatmesëm, edhe pse ky vit ishte një vit i vështirë nga pikpamja e menaxhimit të financave publike, dhe borxhit publik në veçanti. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm kanë qenë faktorët mbizotërues në optimizimin e riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Risku i rifinancimit është përmirësuar, pasi vlera e titujve shtetërorë që maturohen në harkun kohor të një viti është reduktuar me rreth 2.9 pikë përqindje, ndërkohë që jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është pothuaj në të njëjtin nivel me atë të një viti më parë (me një diferencë të lehtë në ulje prej rreth 4 ditësh).

Paraqitje Grafike 5.2 (a): Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2014-2020)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 50.9% në dhjetor 2019 në 46.7% në fund të 2020 (përmirësim/reduktim prej 4.2 pikë përqindje).

Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me 1.5 dhe 1.8 pikë përqindje. Ulja e ekspozimit ndaj këtij risku ka ulur ndjeshmërinë e borxhit ndaj goditjeve të normave të interesit, duke reduktuar burimet që qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.


Paraqitje Grafike 5.2 (b): Ecuria e treguesve të riskut të rifinancimit (2014–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Sa i takon ekspozimi ndaj riskut të kursit të këmbimit gjatë 2020, treguesi përkatës ka pësuar një rritje në krahasim me nivelin e një viti më parë, kjo për shkak të nevojave të shtuara për financim të cilat janë mbuluar (në terma neto) kryesisht nga burime të jashtme. Megjithatë stoku i borxhit shtetëror në monedhë të huaj edhe gjatë vitit 2020 vazhdon të qëndrojë nën kufirin strategjik të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit dhe atë të qëndrueshmërisë së borxhit.

Paraqitje Grafike 5.2 (c): Ecuria e riskut të kursit të këmbimit (2014–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

6. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë


Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë vitit 2020 ka shfaqur kryesisht zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e tregut për tituj shtetërorë në nivele të kënaqshme, e cila ka arritur të mbulojë nevojat e qeverisë për huamarrje në përputhje me objektivat strategjikë dhe; ii) ndërmarrja e aktiviteteve në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së tregut të titujve shtetërorë;

6.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë vitit 2020 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 470.7 miliard Lekë, nga të cilat 291.9 miliard Lekë për bono thesari dhe 178.8 miliard Lekë për obligacione. Kërkesa gjatë këtij viti ka qenë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.29.

Pavarësisht nevojave për hua në rritje dhe pasigurisë së krijuar nga pandemia gjatë muajit prill dhe në vazhdim, tregu i brendshëm ka mbuluar plotësisht nevojat për hua të qeverisë, duke reflektuar besimin e investitorëve ndaj Republikës së Shqipërisë dhe mirëkapitalizimin e sektorit bankar.


Paraqitje Grafike 6.1 (a): Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Viti 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Nga pikëpamja e investitorëve, baza e investitorëve, vijon të jetë e përqëndruar në mbi 60% tek sektori bankar duke e bërë portofolin e borxhit të brendshëm të ndjeshëm ndaj risqeve sistemike që mund të paraqesë ky sektor. Struktura e tregut primar të titujve po konsolidohet nga strategjia e ndjekur duke filluar nga viti 2018, me anë të së cilës synohet zhvillimi i tregut për titujt referencë, si shtysë për zhvillimin e tregut sekondar në të ardhmen.

Paraqitje Grafike 6.1 (b): Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2016–2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


Gjithashtu, gjatë vitit 2020 është vijuar me zbatimin e projektit pilot për emetimin e obligacioneve referencë 3 dhe 5 vjeçare, i cili ka për qëllim të nxisë tregtimin e titujve në tregun sekondar dhe të rrisë zbulueshmërinë e çmimit të titujve, duke reduktuar në këtë mënyrë kostot e huamarrjes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Ky projekt monitorohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si edhe realizohet në bashkëpunim me disa zhvillues tregu (*Market Makers*). Në dallim nga ankandet e zakonshme, në ankandet e obligacioneve referencë në tregun primar lejohet të marrin pjesë vetëm zhvilluesit e tregut (*banka të nivelit të dytë ose institucione të tjera financiare*), të cilët marrin përsipër të tregtojnë këtë titull në tregun sekondar.

6.2. Ecuria e normave të interesit

Normat e interesit në tregun e titujve shtetërorë kanë qenë të qëndrueshme dhe nuk kanë shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2019, pavarësisht kërkesës së shtuar të qeverisë për financim, si pasojë e masave fiskale të mara në kuadrin e parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19. Deri në fillim të muajit maj, normat e interesit për titujt shtetërorë kanë qenë në kahun rritës, duke reflektuar pasigurinë e tregjeve financiare të krijuar nga pandemia, si edhe rritjen e nevojave për hua nga qeveria. Ndërkohë, duke filluar nga fundi i këtij muaji dhe përgjatë muajit qershor normat e interesit kanë qenë kryesisht në rënie, duke përjashtuar këtu instrumentet 5 dhe 7 vjeçare, pasi në tremujorin e fundit këto instrumente kanë hasur rritje të normave të interesit.

Paraqitje Grafike 6.2: Norma mesatare e ponderuar i titujve shtetërorë³ (2018- 2020)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

³ I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.

ANEKSI I

AKRONIME DHE FJALOR SHPJEGUES

AKRONIME

BSH	Banka e Shqipërisë
DMM	Ditët Mesatare në Maturim
EUR	Monedha e Bashkimit Evropian
JPY	Monedha kombëtare e Japonisë
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rifiksion
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PP	Pikë Përqindje
PB	Pikë Bazë
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Monedha Shteteve të Bashkuara të Amerikës
NMP	Norma Mesatare e Ponderuar

FJALOR SHPJEGUES

Ankande shkëmbimi (*exchange auctions*) – Parablerja e titujve shtetërorë më përpara datës së maturimit, ndërkohë që transaksioni kryhet duke e paguar mbajtësin e titullit të parablerë me një titull të emetuar rishtazi.

Borxh – Referuar si “Borxh Total” ose “Totali i detyrimeve të borxhit”, konsiston në të gjitha detyrimet që janë instrumente borxhi.

Borxh afatgjatë – Borxh me afat maturimi më të lartë se një vit.

Borxh i brendshëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj rezidentëve të po atij vendi.

Borxh i jashtëm – Detyrimet e borxhit të rezidentëve të një vendi ndaj jo rezidentëve.

Borxhi publik i garantuar – Detyrimet e borxhit të sektorit publik dhe privat, shërbimi i të cilit është i garantuar me marrëveshje nga njësitë e sektorit publik.

Buyback – Është forma e ndërsjellë e emetimit të titujve shtetërorë, e cila mundëson maturimin e parakohëshëm të një titull shtetëror.

Disbursim – Transaksioni i vënies në dispozicion të burimeve financiare.

Eurobond – Një obligacion (*titull financiar*) me afat maturimi më shumë se një vit i emetuar dhe tregtuar në tregjet ndërkombëtare financiare, jashtë kufijve të vendit që e emeton atë.

Kreditor dypalësh – Tipi i kreditorëve si qeveritë dhe agjencitë e tyre.

Kredi koncesionale – Kredi me terma më të favorshme se ato të tregut.

Kreditor shumëpalësh – Tipi i kreditorëve që përfshinë institucionet financiare si Banka Botërore, FMN, etj..

Kreditorë privatë – Kreditorët që nuk janë as qeveri dhe as agjenci të sektorit publik. Këto përfshijnë mbajtësit privatë të titujve shtetërorë, bankat private dhe institucionet e tjera financiare.

KMM – Tregues i riskut të ri-financimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t’u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është risku i ri-financimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM për instrumentet financiare të borxhit përllogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMM = \frac{\sum_{t \in T} t Nt}{\sum_{t \in T} Nt}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;

N_t – Vlera nominale që do të paguhet në datën t .

KMR – Tregues i riskut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është risku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. KMR për instrumentet financiarë të borxhit përlogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{KMR} = \frac{\sum_{r \in R} r N_r + \sum_{t \in T} t N_t}{\sum_{r \in R} N_r + \sum_{t \in T} N_t}$$

Nga ku:

r – data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
 t – data e maturimit të instrumentit me norma interesi fikse;
 N_r – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;
 N_t – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fikse;
 R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;
 T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fikse.

PBG – Është garanci e emtuar nga Banka Botërore, e cila garanton vlerën e plotë ose të pjesshme të një huaje, me qëllim mundësimin e saj me kosto më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

Raport mbulimi – Raporti ndërmjet shumës së kërkuar (nga investitorët) dhe shumës së ofruar (nga shteti) në ankandet e titujve shtetërorë. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimin të ankandëve dhe gjendjen e likuiditetit.

Risku i kursit të këmbimit – I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një valute, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë. Psh.: “Mbiçmimi ose nënçmimi i monedhës vendase kundrejt një monedhe të huaj, e cila është pjesë përbërëse e portofolit të borxhit, mund të rezultojë në rënie ose rritje proporcionale të volumit të borxhit ose shërbimit të tij (të denominuar në monedhë vendase)”.

Risku i likuiditetit – Risku që lidhet me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe ekzekutimin në kohë të shpenzimeve buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij risku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Risku i normave të interesit – Risku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky risk krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme në të ardhmen.

Risku operacional – Risku që ka të bëjë me rritjen e koston së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, dëmtimit të pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj. Risku operacional është një risk relativisht i vështirë për t'u matur dhe vlerësuar. Ulja e ekspozimit të riskut operacional mund të arrihet nëpërmjet

integritit të procedurave të menaxhimit të borxhit në një strukturë organizative, duke pasur strukturën, infrastrukturën dhe procedurat të drejtuara nga aktivitete operacionale efçente për menaxhimin e administratës shtetërore dhe tregjeve financiare.

Risku i rifinancimit – Risku që lidhet me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim ri-financimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është risku i ri-financimit dhe anasjelltas. Risku i ri-financimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve ndikon në reduktimin e riskut të ri-financimit.

Stoku i borxhit – Balanca e principalit të borxhit në një moment të dhënë të kohës.

Shërbim i borxhit – Pagesat e principalit dhe interesit në përputhje me termat e përcaktuara në marrëveshje.

Sistemi Primary Dealer – Është një marrëveshje institucionale ndërmjet strukturës përgjegjëse për menaxhimin e borxhit dhe disa ndërmjetësve financiarë (*që kanë funksione të specializuara në tregun e titujve shtetërorë*), me qëllim zbatimin e një strategjie që ka për funksion sigurimin e nevojave për financim të qeverisë dhe zhvillimin e tregut të titujve.

Tregu primar – Është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt.

Tregu sekondar – Është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emetuar në tregun primar.

Tituj afatmesëm – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi nga 2 deri në 5 vite.

Tituj afatgjatë – I referohet titujve të borxhit shtetërorë me afat maturimi mbi 5 vite.

Tituj referencë (*benchmark*) – Është emetimi më i fundit i titujve të shtetit shqiptar për një maturitet të caktuar. Ankandi për titullin referencë mund të rihapet periodikisht deri në arritjen e një vlere të paracaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ky titull përdoret si pikë referimi për vlerësimin e titujve të tjerë shtetërorë me maturitet, shumë emetimi dhe normë kuponit të ngjashëm.

Përgjithësisht, titujt referencë gëzojnë likuiditet më të lartë se emetimet e zakonshme, për shkak të detyrimit që kanë Zhvilluesit e Tregut për të kuotuar çmime blerjeje/shitjeje në tregun sekondar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Tituj shtetërorë – Janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në përputhje me ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”; si edhe aktet nënligjore.

ANEKSI II

TË DHËNA SHITESË

1. STOKU I BORXHIT PUBLIK DHE QEVERISJES QENDORE

Tabela 1.0: Stoku i borxhit publik (2016- 2020) (në milion Lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020
Borxhi Publik	1.066.610,3	1.088.169,3	1.107.284,5	1.112.625,9	1.224.470,4
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1.065.709,0	1.087.341,9	1.106.568,8	1.112.044,2	1.224.038,2
Borxhi i Pushtetit Lokal	901,3	827,5	715,7	581,7	432,1
PBB	1.472.479,6	1.550.644,0	1.635.715,0	1.679.284,2	1.572.269,4
Borxhi Publik/PBB	72,4%	70,2%	67,7%	66,3%	77,9%
Borxhi i Qeverisjes Qendrore/PBB	72,4%	70,1%	67,7%	66,2%	77,9%
Borxhi i Pushtetit Lokal/PBB	0,1%	0,1%	0,0%	0,0%	0,0%

Tabela 1.1: Stoku i Borxhit të qeverisjes qendrore (2016- 2020) (në milion Lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1.065.709,0	1.087.341,9	1.106.568,8	1.112.044,2	1.224.038,2
Borxhi i Brendshëm	561.120,0	577.055,7	580.310,3	597.290,0	644.087,8
Borxhi i Jashtëm	504.589,0	510.286,2	526.258,5	514.754,2	579.950,4

Tabela 1.2: Stoku i Borxhit të qeverisjes qendrore (2016- 2020) (në milion Lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020
Borxhi i Qeverisjes Qendrore	1.065.709,0	1.087.341,9	1.106.568,8	1.112.044,2	1.224.038,2
Borxhi Shtetëror	1.012.241,0	1.037.456,7	1.061.896,8	1.070.191,4	1.175.225,5
Borxhi i Garantuar	53.468,0	49.885,2	44.672,1	41.852,8	48.812,7

Tabela 1.3: Kompozimi i stokut të borxhit të qeverisjes qendrore (2018- 2020)

Kompozimi	2018		2019		2020	
	mln Lekë	% / Totalit	mln Lekë	% / Totalit	mln Lekë	% / Totalit
I. Sipas Maturitetit Original	1.106.568,8	100,0%	1.112.044,2	100,0%	1.224.038,2	100,0%
i. Afatshkurtër	209.762,7	19,0%	208.893,7	18,8%	204.632,6	16,7%
Tituj Shtetërorë	194.544,9	17,6%	193.739,3	17,4%	200.436,5	16,4%
Kredi	15.217,8	1,4%	15.154,4	1,4%	4.196,1	0,3%
ii. Afatgjatë	896.806,1	81,0%	903.150,5	81,2%	1.019.405,6	83,3%
Tituj Shtetërorë	463.112,6	41,9%	479.723,8	43,1%	572.609,6	46,8%
Kredi	433.693,5	39,2%	423.426,7	38,1%	446.796,0	36,5%
II. Sipas Monedhës	1.106.568,8	100,0%	1.112.044,2	100,0%	1.224.038,2	100,0%
Monedhë Kombëtare	565.813,0	51,1%	592.614,1	53,3%	629.291,8	51,4%
Monedhë e Huaj	540.755,8	48,9%	519.430,1	46,7%	594.746,5	48,6%
III. Sipas Residencës	1.106.568,8	100,0%	1.112.044,2	100,0%	1.224.038,2	100,0%
Kreditorë Vendas	601.872,1	54,4%	623.443,4	56,1%	679.260,4	55,5%
Kreditorë të Huaj	504.696,7	45,6%	488.600,8	43,9%	544.777,9	44,5%
IV. Sipas Tipit të Interesit*	1.091.351,0	98,6%	1.096.889,8	98,6%	1.210.741,5	98,9%
Interesa Fikse	802.200,8	72,5%	818.736,5	73,6%	922.201,2	75,3%
Interesa të Ndryshueshme	289.150,2	26,1%	278.153,3	25,0%	288.540,3	23,6%
V. Sipas Koncesionalitetit*	1.091.351,0	98,6%	1.096.889,8	98,6%	1.210.741,5	98,9%
Interesa Koncesionale	241.001,0	21,8%	234.715,7	21,1%	226.961,0	18,5%
Interesa Tregtare	850.350,0	76,8%	862.174,1	77,5%	983.780,6	80,4%

*Nuk përfshihet borxhi i brendshëm i garantuar

2. HUAMARRJA SHTETËRORE

Tabela 2.0: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme dhe të jashtme në terma bruto (2019-2020)

Burimet e Huamarrjes	2019		2020	
	Vlera (në mld Lekë)	%/Total	Vlera (në mld Lekë)	%/Total
Burime të Brendshme	301,2	93,4%	349,7	74,2%
Bono Thesari	197,7	61,3%	223,9	47,5%
Obligacione	103,5	32,1%	125,8	26,7%
Burime të Jashtme	21,4	6,6%	121,3	25,8%
Hua për financimin e projekteve	19,6	6,1%	17,35	3,7%
Mbështetje Buxhetore	1,7	0,5%	23,8	5,1%
Eurobond	0,0	0,0%	80,1	17,0%
Total Huamarrja	322,6	100,0%	471,0	100,0%

3. KOSTOT

Tabela 3.0: Shërbimi i borxhit shtetëror (2016 -2020) (në milion Lekë)

	2016	2017	2018	2019	2020
Shërbimi i Borxhit Shtetëror	58.257,5	57.672,5	88.191,9	64.933,4	96.091,7
Interesat e Borxhit Shtetëror	36.259,5	31.903,8	36.513,4	35.142,8	34.393,4
Interesat e Borxhit të Brendshëm	25.526,5	21.414,6	23.158,0	22.837,9	22.350,9
Interesat e Borxhit të Jashtëm	10.733,0	10.489,2	13.355,4	12.304,9	12.042,5
Principali i Borxhit të Jashtëm	21.998,0	25.768,7	51.678,5	29.790,6	61.698,3
PBB	1.472.479,6	1.550.644,0	1.635.715,0	1.679.284,2	1.572.269,4
Shërbimi i Borxhit Shtetëror/PBB	4,0%	3,7%	5,4%	3,9%	6,1%
Interesat e Borxhit Shtetëror/PBB	2,5%	2,1%	2,2%	2,1%	2,2%
Interesat e Borxhit të Brendshëm/PBB	1,7%	1,4%	1,4%	1,4%	1,4%
Interesat e Borxhit të Jashtëm/PBB	0,7%	0,7%	0,8%	0,7%	0,8%
Principali i Borxhit të Jashtëm/PBB	1,5%	1,7%	3,2%	1,8%	3,9%
Të Ardhura Tatimore	369.884,0	398.629,0	419.333,0	426.271,0	398.658,0
Interesa/Të Ardhura Tatimore	9,8%	8,0%	8,7%	8,2%	8,6%

* Krahas shërbimit të borxhit shtetëror përfshihet edhe shërbimi i borxhit që qeveria ka paguar në favor të entiteteve për të cilat ka lëshuar garanci shtetërore.


4. TREGUESIT E TREGUT PRIMAR TË TITUJVE SHTETËRORE

Tabela 4.0: Treguesit e ecurisë së kërkesës dhe ofertës në tregun primar të titujve shtetërorë (2019- 2020)


Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
2019	Nr i ankandeve	25	32	57
	Kërkesa (në mld Lekë)	237,0	161,4	398,4
	Oferta (në mld Lekë)	204,6	104,0	308,6
	Raporti i mbulimit	1,16	1,55	1,29
2020	Nr i ankandeve	33	32	65
	Kërkesa (në mld Lekë)	291,9	178,8	470,7
	Oferta (në mld Lekë)	232,5	131,7	364,2
	Raporti i mbulimit	1,26	1,36	1,29

5. KOMPOZIMI I BORXHIT TË JASHTËM

Paraqitje Grafike 5.0: Stoku i borxhit të jashtëm sipas valutës (2019- 2020)




Paraqitje Grafike 5.1: Stoku i borxhit të jashtëm sipas tipit të interesit (2016- 2020)




*Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar

Paraqitje Grafike 5.2: Stoku i borxhit të jashtëm sipas koncesionalitetit (2016- 2020)



*Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar

Paraqitje Grafike 5.3: Stoku i borxhit të jashtëm sipas kreditorëve (2016- 2020)



*Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar

6. DISBURSIMET E BORXHIT TË JASHTËM

Tabela 6.0: Disbursimet sipas kreditorëve (2016- 2020) (në milion Euro)

	2016	2017	2018	2019	2020
Shumëpalësh	211,2	385,9	229,0	135,9	375,9
Dypalësh	81,0	53,2	42,9	49,2	48,7
Kreditorë Privat	14,9	0,6	498,5	0,0	646,2
TOTAL	307,1	439,7	770,4	185,1	1.070,8

*Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar

Tabela 6.1: Disbursimet sipas sektorëve ekonomik (2016-2020) (në milion Euro)

Sipas sektorëve ekonomikë	2016	2017	2018	2019	2020
ADMINISTRATA SHTETËRORE	1,4	0,9	0,6	0,8	0,9
ARSIMI	1,0	0,3	-	-	0,2
BILANCI I PAGESAVE	-	-	-	-	-
BUJQËSI, UJITJE	-	-	0,1	-	-
ENERGJETIKË	27,2	51,8	153,8	14,2	105,7
IMPORT MALLRASH DHE PAJISJESH	-	-	-	-	-
INDUSTRI E LEHTË	-	-	-	-	-
INFRASTRUKTURË URBANE DHE RURALE	23,7	24,3	21,1	25,5	5,6
KLUBI I PARISIT DHE RISKEDULIME TË TJER	-	-	-	-	-
MBËSHITJE PËR BUXHETIN	153,2	234,3	506,1	14,1	834,9
MBROJTJA	-	-	-	-	-
MBROJTJA E MJEDISIT	0,7	0,0	2,2	0,4	2,1
PYJE	-	-	-	-	-
SHËNDETËSI	1,1	0,6	12,4	7,1	8,5
SIGURIME SHOQ./TREGU I PUNËS	-	-	-	-	-
STREHIMI	-	-	-	-	-
TELEKOMUNIKACION	-	-	-	-	-
TRANSPORT	41,3	79,7	44,3	77,6	72,5
TRANSPORTI AJROR	-	-	-	-	-
TRANSPORTI HEKURUDHOR	-	-	-	-	0,4
UJËSJELLËSA/KANALIZIME	42,4	45,2	29,9	44,6	37,9
ZHVILL. SEK.PRIVAT	-	-	-	-	-
TË TJERA	-	2,1	-	0,9	-
ZHVILLIMI RURAL	0,2	0,6	-	-	1,2
FURNIZIMI DHE TREGTIA	-	-	-	-	1,0
MEDIA TELEVIZIVE	14,9	-	-	-	-
TOTAL	307,1	439,7	770,4	185,1	1.070,8

*Përfshihet borxhi shtetëror dhe borxhi shtetëror i garantuar